



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 9.7.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË NDRYSHIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DUKE
VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, LIDHUR
ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 9 korrik 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bashkim Fino. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj paraqet një propozim të për rishikimin e skemës së TVSH-së në lidhje me projektin TAP, e cila është kombinim i sistemit të autofaturimit (reverse-charge) dhe sistemit tradicional të aplikimit të TVSH-së. Duke marrë në konsideratë jo vetëm rimbursimin e përshpejtuar të TVSH-së për kërkesat e paraqitura tashmë nga projekti TAP, por dhe fluksin në rritje të tyre që pritet të vijojë në vitet 2018 e 2019, mendohet se është i nevojshëm rishikimi i skemës së TVSH-së dhe kalimi në skemën e sipërcituar. Ky propozim, synon të ulë në parametra të menaxhueshëm shumën e kërkesave për rimbursime të TVSH-së, duke bërë të mundur që projekti TAP të mos vihet në vështirësi për financimin e punimeve.

Kjo skemë nënkupton se gjatë fazës së ndërtimit të gjitha furnizimet e nevojshme ndërkombëtare/të huaja dhe vendase të lidhura me projektin TAP, në nivelin e parë dhe të dytë të furnizimeve për projektin TAP do t'i nënshtrohen TVSH-së, nëpërmjet sistemit të autofaturimit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Bashkim FINO

KRYETARI

Ulsi MANJA